



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.5.2023

Nr: 63

Ora: 12:00

U R D H Ë R

PËR

**MARRJEN E MASAVE PËR GARANTIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURAVE
PËR ANËTARË TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET
E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “dh” dhe pika 2, nenit 29, dhe nenit 33 e vijues të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr.20, datë 18.2.2022, të Komisionit Rregullator, “Për kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave” me qëllim garantimin e procesit të verifikimit të kandidaturave të propozuara nga partitë politike për anëtarë dhe sekretarë të grupeve të numërimit të votave në vendin e numërimit të votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023,

U R D H Ë R O J:

1. KZAZ-të të marrin masa për verifikimin e dokumentacionit të kandidatëve për anëtarë dhe sekretarë të GNV-së dhe vlerësimin e legjitimitetit të tyre brenda afatit të përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse, si dhe në Kodin Zgjedhor.
2. Të dërgohen menjëherë në KQZ të dhënat vetëm për kandidaturat për anëtarë dhe sekretarë të GNV-së që plotësojnë kushtet ligjore e kriteret e përcaktuara në vendimin nr.20, datë 18.3.2022, të Komisionit Rregullator, si dhe akte të tjera nënligjore të KQZ-së.
3. KZAZ-ja, përveç të dhënave me natyrë deklarative të referuara në vendimit nr.20, datë 18.3.2022, të Komisionit Rregullator, të sigurohen e të verifikojnë:
 - a) Numrin personal dhe identitetin e kandidatit për anëtar, ose sekretar edhe me anë të kartës së identitetit ose të pasaportës biometrike;
 - b) Vendbanimin e kandidatit për komisioner, duke u siguruar që ai të jetë brenda zonës zgjedhore ku do të ushtrojë funksionin, nëpërmjet certifikatës personale, ose me anë të listës së zgjedhësve të asaj zone zgjedhore (Bashkie) ku kandidati për komisioner ka të drejtën e votës.

Data: 3.5.2023 Nr.63
Ora:12:00



“Për marrjen e masave për garantimin e procesit të verifikimit të kandidaturave për anëtarë të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

4. Për zbatimin dhe ndjekjen e këtij urdhri ngarkohen KZAZ-të dhe administrata e KQZ-së.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 3.5.2023 Nr.63
Ora:12:00



“Për marrjen e masave për garantimin e procesit të verifikimit të kandidaturave për anëtarë të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”